



Prishtinë: 27.08.2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1279\_2020

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2060\_06\_20**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **16.07.2020**.

në seancën e mbajtur më datë **27.08.2020** nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin M.T. nga Komuna e Kacanikut, me shifer të konsumatorit DFE - 9025646, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2060\_06\_20, i datës 10.06.2020.

### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 22.07.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-s, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë, ndaj konsumatorit M.T. nga Komuna e Kacanikut, lidhur me kontestimin e korigjimit plotësues nr.45288DFE - 9025646 të datës 14.11.2017, për këto shkaqe: sipas Departamentit për Kujdes ndaj Konsumatorëve në KESCO, korigjimi plotësues është në përputhshmëri të plotë me rregullat në fuqi dhe se konstatimi nga qendra e kalibrimit se njehsori nuk ka bërë matje në fazën L1 është provë e mjaftueshme që njehsori nuk e ka bërë regjistrimin e shpenzimit të tërësishëm të energjisë elektrike, dhe se çfarëdo analize tjetër duke u bazuar në rrjedhën e energjisë nuk mund ta vërtetoj përqindjen e gabimit në matje.

KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRrE/DMK\_V\_2060\_06\_20, i datës 10.06.2020, për konsumatorin M.T. me shifër DFE 9025646.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.08.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO në të cilën pretendohet që analiza e rrjedhës së energjisë elektrike nuk mund ta vërtetoj përqindjen e gabimit në matje dhe se konstatimi nga qendra e kalibrimit se njehsori nuk ka bërë matje në fazën L1, Bordi i ZRrE thekson se, bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik si dhe me njehsorin e ri, konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore. Sipas analizës të të dy njehsorëve, për periudha të njëjta kohore, ZRrE konstaton se nuk ka ndryshim të shpenzimeve të



energjisë elektrike, përkatësisht nuk ka rritje të shpenzimit. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike, mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik **nr.73447694** është si në vijim:

- Për periudhën 06/2015 – 04/2016 është 1,752 kWh/muaj;
- Për periudhën 06/2016 – 04/2017 është 2,790 kWh/muaj,

Kurse me njehsorin e ri elektrik **nr.67273971**, mesatarja e shpenzimeve mujore është si në vijim:

- Për periudhën 06/2017 – 04/2018 është 2,519 kWh/muaj;
- Për periudhën 06/2018 – 04/2019 është 2,593 kWh/muaj.

Bazuar në krahasimet e bëra, Bordi i ZRrE konstaton se konsumatori nuk ka ndryshim në shpenzimet e regjistruara me dy njehsorët elektrik, përkatësisht ka rënie të shpenzimit me njehsorin e ri elektrik, krahasuar me periudhën kontestuese me njehsorin e vjetër. Pra, Bordi i ZRRE konstaton se po që se njehsori elektrik i konsumatorit nuk do të kishte matur saktë regjistrimin e shpenzimit të energjisë elektrike dhe atë për 33.33% më pak, atëherë me rregullimin e njehsorit elektrik nga punëtorët e autorizuar të KEDS, ajo sasi e energjisë elektrike e cila nuk është regjistruar do të duhej të reflektohej në periudhat pas rregullimit të njehsorit, e që bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike kjo nuk ka ndodhur.

Lidhur me këtë, Bordi i ZRrE ka konstatuar se KESCO nuk ka arritur të argumentojë saktë se njehsori elektrik i konsumatorit me nr.73447694 nuk ka regjistruar saktë shpenzimin e energjisë elektrike ashtu siç është theksuar në procesverbalin e kalibrimit, andaj, KESCO obligohet që të veproj në harmoni me vendimin e DMK/ZRrE, pra, ta anuloj korrigjimin shtesë me nr. 45288DFE-9025646 të datës 14.11.2017 në vlerë prej 1,863.51 E.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.08.2020 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Arsim Janova, u.d. kryesues

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit M. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.